

BANKË ME NJËSI TESTESH

DREJTIMI:

TIK, Niveli I

LËNDA:

“Bazat e elektroteknikës”, klasa 10-të dhe 11-të

1. Rrethoni përgjigjen e saktë. Nëqoftëse në një qark rritet tensioni, atëherë rryma:

(1 pikë)


- A. Rritet
- B. Mbetet e pandryshuar
- C. Zvogëlohet
- D. Bëhet zero

Përgjigje: A

2. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cilin nga ekuacionet e mëposhtëm duhet të zbatojmë për të llogaritur vlerën e tensionit U_{R1} në qarkun e dhënë në figurë:

(1 pikë)

- A. $U_{R1} = 1 / R_1$
- B. $U_{R1} = I^2 R_1$
- C. $U_{R1} = R_1 / I$
- D. $U_{R1} = I R_1$



Përgjigje: D

3. Rrethoni përgjigjen e saktë. Dy rezistorë janë lidhur në paralel në tension te burimi. Tensioni në secilin prej tyre është:

(1 pikë)

- A. I ndryshëm në varësi të rezistencës së rezistorit
- B. I njëjtë në çdo rezistor
- C. Sa gjysma e tensionit të burimit
- D. Sa dyfishi i tensionit të burimit

Përgjigje: B

4. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në një qark elektrik shtimi i një resistance në seri e rrit rezistencën e përgjithëshme ?

(1 pikë)

- A. Po
- B. Jo

Përgjigje: A

5. Rrethoni përgjigjen e saktë. N.q.s dy rezistorë janë lidhur në paralel me burimin e tensionit, rezistenca e përgjithëshme e qarkut është:

(1 pikë)

- A. $R_{nj} = R_1 + R_2$
- B. $R_{nj} = R_1 R_2$
- C. $1 / R_{nj} = 1 / R_1 + 1 / R_2$

D. $R_{nj} = 1 / R_1 + 1 / R_2$

Përgjigje: C

6. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cili nga ligjet e mëposhtme jep përgjigje të drejtpërdrejtë mbi rrymën në një pikë nyje

(1 pikë)

- A. Ligji i Omit
- B. Ligji i parë i Kirkofit
- C. Ligji i dytë i Kirkofit
- D. Ligji i Kulonit

Përgjigje: B

7. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në qarkun me tri llampa në paralel djegia e një llampe sjell fikjen e dy të tjerave

(1 pikë)

- A. PO
- B. JO

Përgjigje: B

8. Rrethoni përgjigjen e saktë. Pajisjet mbrojtëse elektrike shërbejnë për mbrojtjen e:

(1 pikë)

- A. pajisjeve nga lidhjet e shkurtëra
- B. pajisjeve nga ulja e tensionit
- C. mjedisit nga ndotja
- D. punonjësve gjatë punës

Përgjigje: D

9. Rrethoni përgjigjen e saktë. Tensioni i rrezikshëm për njeriun në ambiente normale punë është:

(1 pikë)

- A. 12 V
- B. 24 V
- C. 36 V
- D. 64 V

Përgjigje: D

10. Vendosni shkronjën e duhur nga togfjalëshat (A, B, C) në vendet bosh:

(3 pikë)

Qark elektrik quajmë: (_____)

Elementët kryesore të tij janë: (_____)

Parametrat e tij janë: (_____)


- A. burimi i energjisë; marrësi i energjisë; c-përcjellësit që lidhin marrësin me burimin;
- B. rryma I ; forca elektromotore E (ose tensioni U), rezistenca R;
- C. tërësinë e elementeve që shërbejnë për kalimin e rrymës.

Përgjigje: C-A-B

11. Vizatoni një qark të thjeshtë elektrik dhe shkruaj **ligjin e Omit** për këtë qark.

(3 pikë)


Përgjigje:



$$I = E / (R_1 + R_0)$$

12. Rrethoni përgjigjen e saktë. Sipas ligjit të parë të Kirkofit, cili nga barazimet është i vërtetë për pikë nyjen e dhënë në figurë?

(1 pikë)




- A. $I - I_1 - I_2 + I_3 - I_4 - I_5 = 0 \text{ A}$
- B. $I - I_1 + I_2 + I_3 + I_4 + I_5 = 0 \text{ A}$
- C. $I + I_1 + I_2 + I_3 - I_4 - I_5 = 0 \text{ A}$
- D. $I + I_1 + I_2 - I_3 - I_4 + I_5 = 0 \text{ A}$

Përgjigje: A

13. Rrethoni përgjigjen e saktë. Për skemën e dhënë në figurë rezistorët janë lidhur në:

(1 pikë)



- A. seri
- B. paralel
- C. të përzier
- D. asnjë nga tre mënyrat e mësipërme

Përgjigje: B

14. Rrethoni përgjigjen e saktë. Sa është rezistenca e plotë e qarkut me tri rezistenca të lidhura në paralel n.q.se secili nga rezistorët ka vlerën 3Ω

(2 pikë)

- A. $R_p = 1 \Omega$
- B. $R_p = 3 \Omega$
- C. $R_p = 9 \Omega$
- D. $R_p = 12 \Omega$

Përgjigje: A ($1/R_p = 1/R_1 + 1/R_2 + 1/R_3 = 1/3 + 1/3 + 1/3 = 3/3 = 1 \Omega$)

15. Lidhni me shigjetë parametrat elektrikë me njësitë matëse të tyre.

(2 pikë)

q	I	U	E	P
A	V	W	C	V

Përgjigje: q-C; I-A; U-V; E-V.

16. Shkruani 3 (tri) **formulat**, që përdoren për të llogaritur fuqinë e qarkut elektrik të rrymës së vazhduar

(3 pikë)


Përgjigje:

$$P = UI; \quad P = I^2 R; \quad P = U^2 / R$$

17. Vizatoni qarkun me 3 (tri) rezistenca në paralel dhe shkruani të paktën tri nga vetitë kryesore të tij.

(5 pikë)

Përgjigje:



1. - tensioni në të gjitha degët është i njëjtë:

$$U = U_1 = U_2 = U_3$$

2. - rryma në pjesën e padegëzuar është:

$$I_{\text{tot}} = I_1 + I_2 + I_3$$

3. - gjatë heqjes së një rezistori (këputjes), rryma në degët e tjera nuk ndërpritet;

4. - rezistenca e përgjithëshme llogaritet : $1/R = 1/R_1 + 1/R_2 + 1/R_3$;


5. - fuqia e plotë e qarkut llogaritet

$$P_T = P_1 + P_2 + P_3$$

18. Vizatoni qarkun me 3 (tri) rezistenca në seri dhe shkruani të paktën tri prej vetive kryesore të tij.

(5 pikë)

Përgjigje:



1. - rezistenca e përgjithshme llogaritet:

$$R_T = R_1 + R_2 + R_3$$

2. - tensioni në hyrje të qarkut është:

$$U_T = U_1 + U_2 + U_3$$


3. - rryma është e njëjtë në të gjithë qarkun

4. - hapja e qarkut ndërpret rrymën në qark

5. - $P_T = P_1 + P_2 + P_3$

19. Zgjidhni ushtrimin: Për skemën e dhënë në figurë të llogaritet rezistenca e përgjithshme n.q.s. secila nga rezistencat e skemës ka vlerën $3.3\text{k}\Omega$; dhe rryma në pjesën e padegëzuar të qarkut n.q.s. tensioni në hyrje të qarkut është $U = 660\text{V}$

(3 pikë)



Përgjigje:

$$R_{24} = R_2 + R_4 = 3.3 + 3.3 = 6.6\text{ k}\Omega$$

$$R_{35} = R_3 + R_5 = 3.3 + 3.3 = 6.6\text{ k}\Omega$$

$$R_{2345} = R_{24} \parallel R_{35} = \frac{6.6 \cdot 6.6}{6.6 + 6.6} = 3.3\text{ k}\Omega$$


$$R_p = R_1 + R_{2345} = 3.3 + 3.3 = 6.6\text{ k}\Omega$$

$$I = U/R_p = 660/6.6 \cdot 10^{-3} = 0.1\text{A}$$

20. Për qarkun e dhënë në figurë, janë dhënë: tensioni në qark është 24V konstant dhe rezistencat janë nga 2Ω secila. Llogaritni $R_{\text{përgj}}$, $I_{\text{përgj}}$, I_1 , I_2 dhe I_3 .

(5 pikë)

Series-parallel



Përgjigje:

$$R_{23} = R_2 + R_3 / R_2 R_3 = (2 + 2) / (2 \times 2) = 1\Omega$$

$$R_p = R_{23} + R_1 = 2 + 1 = 3\Omega$$

$$I_{\text{përgj}} = U / R_p = 24 / 3 = 8A$$


$$I_1 = I_p = 8A$$

$$U_2 = U_3 = I_p \times R_{23} = 8 \times 3 = 24V$$

$$I_2 = I_3 = U_2 / R_2 = 24 / 2 = 12A \text{ (ose në bazë të Ligjit të parë të Kirkofit m.q.s. } R_2 = R_3 \text{ atëherë } I_1 + I_2 = I / 2 = 8 / 2 = 4A)$$

21. Të zgjidhet ushtrimi: Në skemën e dhënë në figurë, kur qarku është i hapur, bateria e lidhur në të tregon tensionin $E = 45V$.

Kur në qark lidhet rezistori $R_x = 9\Omega$ tensioni i matur është $U = 40.5V$.



- Gjeni humbjet e tensionit në bateri.
- Llogaritni rrymën në qark.
- Llogaritni rezistencën e brendshme të baterisë.

(3 pikë)

Përgjigje:


$$a) U_0 = E - U = 45 - 40.5 = 4.5V$$

$$b) I = U / R = 40.5 / 9 = 4.5A$$

$$c) R_0 = U_0 / I = 4.5 / 4.5 = 1\Omega$$

22. Rrethoni përgjigjen e saktë. Për qarkun e dhënë në figurë të llogaritet vlera e rezistencës R_x n.q.s. rryma $I = 3mA$ dhe tensioni i burimit $U_s = 4.5V$.

(2 pikë)



A. $R_x = 1.5\Omega$

B. $R_x = 15\Omega$

C. $R_x = 150\Omega$

D. $R_x = 1.5\text{k}\Omega$

Përgjigje: D ($R_x = U/I = 4.5/3 \cdot 10^{-3} = 1.5 \text{ k}\Omega$)

BANKË ME NJËSI TESTESH

DREJTIMI:

TIK, Niveli I

LËNDA:

“Bazat e kompjuterit”, klasa 10-të dhe 11-të

1. Rrethoni përgjigjen e saktë. Të dhënat në memorjen e punës/operative (RAM) mbeten edhe pas fikjes së kompjuterit.

(1 pikë)

PO

JO

Përgjigje: JO

2. Rrethoni përgjigjen e saktë. Zgjedhja e madhësisë së kasës së kompjuterit ATX apo ATX mini nuk ka të bëjë me mundësinë për zgjerim në të ardhmen me elemente të tjera shtesë (shtim i një HDD tjetër, karta rrjeti, zëri, video, etj.) apo me largimin më të mirë të nxehtësisë gjatë punës.

(1 pikë)

PO

JO

Përgjigje: JO

3. Rrethoni përgjigjen e saktë. Procesori punon më shpejt n.q.se i merr të dhënat dhe informacionet nga cache-ja e tij sesa nga memorja e sistemit. Pra, sa më e madhe cache-ja aq më shpejt procesohen të dhënat nga procesori.

(1 pikë)

PO

JO

Përgjigje: PO

4. Rrethoni përgjigjen e saktë. Fuqia që zgjedhim për bllokun e ushqimit nuk varet nga karta grafike, por vetëm nga procesori.

(1 pikë)

PO

JO

Përgjigje: JO

5. Rrethoni përgjigjen e saktë. BIOS është një software, i vendosur në një chip ROM ose në një flash memory chip, i cili përmban një kod me instruksione që përcakton se çfarë kompjuteri mund të bëjë pa aksesuar ende programet nga disku i ngurtë.

(1 pikë)

PO

JO

Përgjigje: PO

6. Rrethoni përgjigjen e saktë. Portat seriale, paralele dhe PS/2 janë zëvendësuar gjerësisht nga portat USB.

(1 pikë)

Përgjigje: JO

7. Shtoni fjalët që mungojnë për të plotësuar kuptimin e fjalisë:

Disqet e ngurtë (hard disks)_____ përdorin një krah mekanik me një kokë lexuese/shkruese në fund, i cili lëviz përgjatë një pllake magnetike ku është magazinuar informacioni. Disqet e ngurtë, që përdorin një teknologji më të re, pa pllaka magnetike dhe krah mekanik, quhen _____

(2 pikë)

Përgjigje:;

Disqet e ngurtë (hard disks) **IDE/SATA** përdorin një krah mekanik me një kokë lexuese/shkruese në fund, i cili lëviz përgjatë një pllake magnetike ku është magazinuar informacioni. Disqet e ngurtë, që përdorin një teknologji më të re, pa pllaka magnetike dhe krah mekanik, quhen **SSD (Solid State Drive)**.

8. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cilat prej pajisjeve të mëposhtme është pajisje dalëse e informacionit.

(1 pikë)

- A) mikrofoni
- B) tastiera
- C) mausi
- D) printeri

Përgjigje: D

9. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila prej shkurtimeve të mëposhtme nuk ka të bëjë me disqet e ngurtë (*harddisks*)?

(1 pikë)

- A) IDE
- B) PCI
- C) SSD
- D) SATA

Përgjigje: B

10. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila prej teknologjive të mëposhtme të monitorëve ofron, përveç qartësisë më të madhe të figurës, cilësi më të lartë të ngjyrave, dinamicitetit të pamjes dhe efikasitet më të lartë në konsumin e energjisë?

(1 pikë)

- A) LED
- B) CRT
- C) TFT
- D) LCD

Përgjigje: A

11. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila nga ndërfaqet ofron shpejtësi më të lartë transferimi të dhënash?

(1 pikë)

- A) USB 1.1
- B) Firefire 400
- C) USB 2.0
- D) USB 3.0

Përgjigje: D

12. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cili nga modelet e mëposhtme të disqeve të ngurtë ofron shpejtësi më të madhe:

(1 pikë)

- A) SAS 10K rpm
- B) IDE 5400 rpm
- C) SATA 7200 rpm
- D) EIDE 5400 rpm

Përgjigje: A

13. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cili nga modulet e mëposhtme të memorjes DIMM (dual in-line memory module) përdoret për laptop-ët?

(1 pikë)

- A) 240 PIN DIMM (DDR2 dhe DDR3 SDRAM)
- B) 200 PIN SODIMM (DDR SDRAM)
- C) 184 PIN DIMM (DDR, SDRAM)
- D) 168 PIN DIMM (FPM, EDO, SDRAM)

Përgjigje: B

14. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila prej lidhjeve të mëposhtme mund të transmetojë përveç sinjalit video digital edhe sinjal audio?

(1 pikë)

- A) VGA
- B) RGB
- C) HDMI
- D) DVI

Përgjigje: C

15. Për të shmangur humbjen e të dhënave, në rast defekti të diskut të ngurtë, mund të vendosen dy disqe të ngurtë me të njëjtin kapacitet në “mirror” (pasqyrë) me ndihmën e një kontrolleri hard ose software. Si quhet sistemi RAID i përdorur në këtë rast?

(1 pikë)

- A) RAID 0
- B) RAID 1
- C) RAID 5
- D) RAID 10

Përgjigje: B

16. Bashkoni saktë elementët në të dy anët e listës, që janë pjesë ose kanë lidhje me njëra tjetrën:

(6 pikë)

- | | |
|--------------------|------------------------|
| 1. Motherboard | a. Microsoft Windows 8 |
| 2. Procesor | b. Chipset |
| 3. Kasë kompjuteri | c. Bllok ushqimi |

- | | |
|-----------------------|--------------------------|
| 4. Kartë grafike | d. Microsoft Office 2013 |
| 5. Sistem shfrytëzimi | e. Cache |
| 6. Program aplikativ | f. Kabëll VGA |
| | g. Motor kerkimi |
| | h. Antivirus |

Përgjigje: 1-b; 2-e; 3-c; 4-f; 5-a; 6-d

17. Bashkoni saktë elementët në anën e majtë të listës me njësitë matëse të kapaciteteve korresponduese në anën e djathtë:

(6 pikë)

- | | |
|------------------|---------------------|
| 1. Harddisk SATA | a. 700 MB |
| 2. USB stick | b. 4.7 GB |
| 3. DVD-ROM | c. 8 GB |
| 4. Kartë rrjeti | d. 22" (1920x1080) |
| 5. CD-ROM | e. 1 TB |
| 6. Monitor | f. 10/100/1000 MBps |
| | g. MHz |
| | h. Mikron |

Përgjigje: 1-e; 2-c; 3-b; 4-f; 5-a; 6-d

18. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme duke përdorur *file systems* (sistem të organizimit të ruajtjes së informacionit) të dhëna më poshtë. Zgjidhni ato që i korrespondojnë sistemit të shfrytëzimit përkatës.

(4 pikë)

Ext3, HFS+, UFS (ZFS, JFS), FAT, Ext2, NTFS

- A) Cilin *file system* përdor zakonisht sistemi i shfrytëzimit Linux?
 B) Cilin *file system* përdor zakonisht sistemi i shfrytëzimit Windows?
 C) Cilin *file system* përdor zakonisht sistemi i shfrytëzimit MAC?
 D) Cilin *file system* përdor zakonisht sistemi i shfrytëzimit Unix/Solaris?

Përgjigje:

A- Ext2, Ext3; B- FAT, NTFS; C- HFS+; D- UFS (ZFS, JFS)

19. Keni shembullin e një moduli RAM - DDR 3, 4 GB, 1600 MHz. Tregoni tre karakteristikat bazë që mund të nxirren nga ky shembull, të cilat duhen patur parasysh para se të blihet një modul RAM-i.


(3 pikë)

Përgjigje:

1. Lloji i RAM-it = DDR 3
2. Madhësia = 4 GB
3. Shpejtësia e bus-it/Frekuenca = 1600 MHz

20. Në tabelën e mëposhtme jepen elementë të motherboard-it në figurë. Vendosni numrin që korrespondon në figurë krahas elementit përkatës në tabelë.

(8 pikë)



Nr.	Elementi	Nr.	Elementi	Nr.	Elementi
	Konektori SATA		Socketi i CPU-së		Bateria e motherboard-it
	Slote memorje		Sloti PCI express		Konektori IDE
	Slote PCI				Konektori fuqise ATX 24 Pin

Përgjigje:

Konektori SATA-8; Slote memorje-3; Slote PCI-18; Socketi i CPU-së-1; Sloti PCI express-20;

Bateria e motherboard-it-25; Konektori IDE-6; Konektori fuqise ATX 24 Pin-5.

21. Përdorni elementin e duhur të motherboard-it për të plotësuar fjalitë e mëposhtme.


(4 pikë)

- A) _____ përdoret për lidhjen e disqeve të ngurtë dhe atyre optikë me motherboard-in. Lidhja kryhet me kablllo me 7 kunjë (pin) përçues. Ofron transferim më të shpejtë dhe më efikas të dhënash, si dhe hot swapping.
- B) _____ përdoret për lidhjen e disqeve të ngurtë dhe atyre optikë me motherboard-in. Lidhja kryhet me kablllo me 40 kunjë (pin) përçues.
- C) _____ është një slot i shpejtësisë së lartë për zgjerimin e kapacitetit të kompjuterit. Ai ka rendiment dhe performancë më të lartë se pararendësit, ka numër kunjash përçuese më të vogël, mundëson hot-plug, si dhe ofron një mekanizëm më të avancuar dedektimi të gabimit.
- D) _____ bën të mundur ruajtjen e të dhënave të CMOS-it.

Përgjigje: A-Konektori SATA; B- Konektori IDE; C- PCI express; D- Bateria e motherboard-it

22. Nga bashkësia e emrave të portave, zgjidhni dhe plotësoni vendet bosh të listës vetëm me emrat e atyre portave që u përkasin numrave referuar figurës.

(6 pikë)



Porta 1 _____

Porta 3 _____

Porta 5 _____

Porta 10 _____

Porta 12 _____

Porta 13 _____

Bashkësia e emrave të portave (Kujdes! Ka më shumë emra portash sesa nevojiten).

Paralele (LPT); USB; seriale (RS232); PS/2; eSATA; LAN (RJ 45); mikrofoni; altoparlanti; VGA; HDMI; DVI; firewire.

Përgjigje:

Porta 1 = PS/2; porta 3 = VGA; porta 5 = LAN (RJ 45); porta 10 = Mikrofon; porta 12 = USB; porta 13 = DVI.

23. Përmendni dhe përshkruani shkurt të paktën katër karakteristika bazë që duhen marrë parasysh kur blihet një printer.

(4 pikë)

Përgjigje:

1. Printer bardh e zi apo me ngjyra
2. Madhësia e letres (A3, A4, etj)
3. Shpejtësia e printimit faqe për minut (angl. ppm)
4. Cilësia e printimit, e cila matet me dot per inch (dpi)
5. Mënyra e lidhjes (USB, LAN, Wireless)
6. Kompatibiliteti me sistemet e shfrytëzimit me të cilat do përdoret
7. Kostot operative (çmimi i tonerit/tonerave)

BANKË ME NJËSI TESTESH

DREJTIMI:

TIK, Niveli I

LËNDA:

“Programet aplikative”, klasa 10-të dhe 11-të

1. Rrethoni përgjigjen e saktë. Si realizohet aktivizimi i Excel-it:

(1 pikë)

- A) Start Programs Microsoft Office Microsoft Excel
- B) Edit Programs Microsoft Office Microsoft Excel
- C) File open project
- D) File new blank database

Përgjigje: A

2. Rrethoni përgjigjen e saktë. Si bëhet mbledhja e qelizave D4, D5, D6, D7:

(1 pikë)

- A) D4+D5+D6+D7
- B) D4:D7
- C) =D4+D5+D6+D7
- D) =max (D4+D5+D6+D7)

Përgjigje: C

3. Rrethoni përgjigjen e saktë. Programi, i cili bën kombinimin e materialeve të teksteve, grafikës, videos, zërit dhe animacioneve quhet:

(1 pikë)

- A) Power Point
- B) Paint
- C) Multimedia
- D) Photoshop

Përgjigje: C

4. Rrethoni përgjigjen e saktë. Nëse vlera e x-it është e vendosur në qelizën A1, e y-it në A2 dhe z në A3, formula e cila bën llogaritjen e vlerës së shprehjes matematikore për $\text{Min}(xy+z, xy-z)$ në programin e MS Excel është:

(1 pikë)

- A) =MIN(A1*A2+A3,A1*A2-A3)
- B) MIN(A1*A2+A3,A1*A2-A3)
- C) MAX(A1*A2+A3,A1*A2-A3)
- D) =MAX(A1*A2+A3,A1*A2-A3)

Përgjigje: A

5. Rrethoni përgjigjen e saktë. Insert worksheet në MS excel përdoret për:

(1 pikë)

- A) Insertimin e një rreshti
- B) Insertimin e një kolone
- C) Insertimin e një flete pune
- D) Insertimin e një grafiku

Përgjigje: C

6. Rrethoni përgjigjen e saktë. Çfarë është "electronic commerce"?

(1 pikë)

- A. Mënyrë e porositjes dhe pagesës së mallrave nëpërmjet Internetit
- B. Emërtim i përbashkët i industris së mallrave nëpërmjet internetit
- C. Emërtim i përbashkët për të gjithë industrinë elektronike
- D. Kuptim i panjohur në TIK

Përgjigje: A

7. Rrethoni përgjigjen e saktë. Nëse versioni i ri i një dokumenti ruhet me emërim plotësisht identik me atë paraprak në të njëjtin folder (replace), atëherë dokumenti i versionit paraprak do të:

(1 pikë)

- A) Ruhet në recycle bin
- B) Ruhet ashtu si ka qenë
- C) Humbasë tërësisht
- D) Humbet vetëm emërtimi

Përgjigje: C

8. Rrethoni përgjigjen e saktë. Programi i cili nuk ka të bëjë me internetin është:

(1 pikë)

- A) Outlook Express
- B) Internet explorer
- C) Windows explorer
- D) Microsoft Office Outlook

Përgjigje: C

9. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cili program përdoret si Web Browser:

(1 pikë)

- A) Google
- B) MS Outlook
- C) Windows Explorer
- D) Internet explorer

Përgjigje: D

10. Rrethoni përgjigjen e saktë. Programi, i cili përdoret si Search Engine (motor kërkimi) është:

(1 pikë)

- A) Internet Explorer
- B) Windows explorer
- C) MS Outlook
- D) Google

Përgjigje: D

11. Rrethoni përgjigjen e saktë. Kualiteti i fotografisë në monitor varet nga:

(1 pikë)

- A) Printerit
- B) Tastierës
- C) Kartelës së rrjetit
- D) Karta grafike

Përgjigje: D

12. Rrethoni përgjigjen e saktë. Gjeni tab-in e futur gabim në shiritin e tabe-ve të dhënë më poshtë :

(1 pikë)

- A) Home
- B) Insert
- C) Page Layout
- D) Data

Përgjigje: D

13. Rrethoni përgjigjen e saktë. Përmes opsionit Reply, në e-mail-in e pranuar do të:

(1 pikë)

- A) Ruajmë në disk
- B) Përgjigjemi dërguesit
- C) Ruajmë adresën e dërguesit
- D) Bllokojme adresën e dërguesit

Përgjigje: B

14. Rrethoni përgjigjen e saktë. ISP-të janë:

(1 pikë)

- A) Protokolle
- B) Ofrues të shërbimeve të internetit
- C) Komunikim me koneksion
- D) Web browser

Përgjigje: B

15. Rrethoni përgjigjen e saktë. Për të ruajtur versionin e ri të dokumentit në adresat e ndryshme nga ajo e origjinalit, ai duhet të ruhet me opsionin:

(1 pikë)

- A) Copy As
- B) Save As
- C) Upload
- D) Save

Përgjigje: B

16. Çfarë quajmë Web browser dhe përse përdoren favoritet në një web browser?

(2 pikë)

Përgjigje:

Web browser quhet ndryshe shfletues i faqeve të internetit.

Favoritet përdoren në ato raste kur kemi gjetur një sajt që na pëlqen shumë dhe dëshirojmë të kthehemi shpejt në të, pa patur nevojën të bëjmë kërkimin apo shfletimin nga lidhja në lidhje, ose të mos preokupohemi për të mbajtur mend adresën.

17. Rrethoni përgjigjet e sakta. Llogaritja e shumës së qelizave F4,F5,F6,F7,F8 :

(2 pikë)

- A) =SUM(F4+F5+F6+F7+F8)
- B) =SUM(F4:F8)

C) =SUM(F4-F5-F6-F7-F8)

D) =SUM(F4,F8)

Përgjigje: A, B

18. Rrethoni përgjigjen e saktë. Pjesa e një dokumenti që lidh një dokument me një dokument tjetër quhet:

(1 pikë)

A) Relationship

B) Hyperlink

C) Web faqe

D) eConection

Përgjigje: B

19. Çfarë quajmë programe aplikative ?

(1 pikë)

Përgjigje :

Janë të gjitha programet bazë të kompjuterit që ne i përdorim pasi sistemi operativ të ketë startuar.

20. Përshkruani stilin dhe kahjen e përdorur për formatimin e shkronjave në tabelën e mëposhtme:

(6 pikë)

A	B	C
<u>Dielli</u>	Dielli	<i>Dielli</i>

A)

B)

C)

Përgjigje:

A.....Stili i përdorur është (underline) ose i vijëzuar ndërsa pozicionimi është djathtas (align text right)

B.....Stili i përdorur është (bold) ose i theksuar ndërsa pozicionimi është në qendër (center)

C.....Stili i përdorur është i pjerrët (italic) dhe i theksuar(bold) ndërsa pozicionimi është majtas (align text left)

21. Shpjegoni veprimet që mund të kryhen, me anë të 3 komandave standart të QUICK ACCESS TOOLBAR të paraqitura në figurë, gjatë punës me një dokument në Word 2007:

(3 pikë)





1. _____
2. _____
3. _____

Përgjigje:

1. Save (ruaj); 2. Undu (prapa); 3. Redu (përpara).

22. Tregoni dallimin ndërmjet RIBBON dhe TOOL BAR në programin Word 2007.

(2 pikë)

Përgjigje :

Ribbon është paneli, ku janë të vendosura tabet më kryesore ndërsa tool bar është menuja me të gjitha mjetet e punës që disponon Word 2007.

23. Cili është funksioni i opsionit “forward” në outlook?

(1 pikë)

Përgjigje :

Opsioni “forward” në outlook shërben për të dërguar, një mesazh të ardhur, në një adresë tjetër.

24. Ç’kuptoni me “attach file” në një e-mail?

(1 pikë)

Përgjigje :

Quhet ndryshe mesazhi në të cilin mund të bashkëngjitem një skedar text, muzikë apo imazh.

25. Çfarë është “ruler” në Word 2007 dhe për çfarë shërben?

(2 pikë)

Përgjigje :

Vizorja shfrytëzohet për vendosjen e tab pozitave dhe kryerreshtit. Ajo, gjithashtu, shërben edhe për rregullimin e kufinjve të tabelave.

26. Plotësoni vendin bosh:

(1 pikë)

Grupi i instruksioneve që përdoren për të ndërtuar një program quhet

Përgjigje :

Grupi i instruksioneve që përdoren për të ndërtuar një program quhet **gjuhë programimi**.

27. Me çfarë komandash e rregullojmë orientimin e fletës punuese tek Word 2007?

(3 pikë)

Përgjigje :

Klikojmë Page Layout- Orientation- portrait (vertical) ose landscape (horizontal).

28. Çfarë tipi të skedarit përmban dokumenti në Microsoft Word 2007?

(1 pikë)

Përgjigje : Tipi i dokumentit docx.

29. Cilat janë kategoritë e instrumenteve të kërkimit në Internet?

(4 pikë)

Përgjigje :

- Motorët e kërkimit,të cilët shpesh tregohen me emrin Search Engine
- Direktoritë ose katalogët
- Metamotorët
- Portalët

30. Ku qëndron ndryshimi midis motorit të kërkimit dhe metamotorit?

(2 pikë)

Përgjigje:

Motorët e kërkimit lejojnë të individualizohen fjalë (keywords) ose kombinime fjalësh në një arkivë, që tregon dokumentet në formë dixhitale, ndërsa metamotoret lejojnë të kenë akses të njëkohshëm në dokumentet e ruajtur nga shumë motorë.

31. Ç'kuptoni me termat:

(3 pikë)

CPU.....
.....
.....
.....
RAM.....
.....
.....
.....
NIC.....
.....
.....
.....

Përgjigje :

CPU - Proçesori është komponenti kryesor i kompjuterit, i cili bën ekzekutimin e programeve individuale. Quhet edhe njësia qendrore proçesorike (CPU-central procesor unit)

RAM (random access memory) – është memorja me akses të rastësishëm, Quhet ndryshe dhe memorja e përkohshme e kompjuterit që ruan informacionin për një kohë të shkurtër.

NIC (network interface card)- Karta për ndërfaqen e rrjetit e cila shërben për t'u lidhur me rrjetin ose me kompjuterat e tjerë ne rrjet.

32. Për çfarë shërbejnë këto komanda në word:

(4 pikë)

Ctrl + N.....
Ctrl + O.....
Ctrl + S.....
Ctrl + P.....

Përgjigje :

Për të hapur një dokument të ri – Ctrl + N

Për të hapur dritaren e navigimit – Ctrl+O

Për të ruajtur një dokument – Ctrl + S

Për të printuar një dokument – Ctrl+P

33. Plotësoni vendet bosh:

(4 pikë)

Për të selektuar komplet dokumentin – Ctrl + _____
Për të kopjuar dokumentin e selektuar – Ctrl + _____
Për të prerë (cut) dokumentin e selektuar – Ctrl + _____
Për të kaluar (paste) dokumentin në një vend tjetër – Ctrl + _____

Përgjigje :

Për të selektuar komplet dokumentin - Ctrl + A

Për të kopjuar dokumentin e selektuar - Ctrl + C

Për të prerë (cut) dokumentin e selektuar - Ctrl + X

Për të kaluar (paste) dokumentin në një vend tjetër - Ctrl + V

34. Cilat janë ndryshimet ndërmjet memorieve DRAM dhe SRAM:


(5 pikë)

Përgjigje :

Memoria dinamike RAM(DRAM) kërkon rifreskim të vazhdueshëm për të mirëmbajtur të dhënat në të dhe i referohet tendencës që të dhënat të fshihen pas një kohe ndërsa SRAM nuk ka nevojë (si memoria DRAM) për rifreskim. Është më e shpejtë se DRAM por edhe më e kushtueshme.

35. Shpjegoni figurën e mëposhtme:

(4 pikë)



Përgjigje :

FIND & REPLACE

Nqs duhet të gjejmë një fjalë ose një frazë në dokumentin në të cilin po punojmë duhet të shtypim Find(Ctrl+F). Kjo është një komandë mjaft e rëndësishme kur kemi shumë tekst. Me ekzekutimin e komandës Find, Word kontrollon të gjithë dokumentin. Nqs duam që kërkimin ta kemi të kufizuar në një pjesë të veçantë të tekstit atëherë selektojmë tekstin dhe kërkojmë për fjalën që na nevojitet. Pasi e kemi gjetur fjalën mund ta zëvendësojmë atë me një tekst të ri duke përdorur në këtë rast komandën Replace.

36. Çfarë kuptoni me letra në seri në programin Word 2007?

(3 pikë)

Përgjigje :

Shpesh nevojitet që shumë personave njëherësh t'u dërgohet e njëjta ftesë apo dokument. Për këtë nevojitet që fillimisht të hartohet dokumenti kryesor i thirrjes dhe më pas për secilin person apo institucion të mblidhet një informacion kontakti me shumë fusha. Më pas dokumenti kryesor u nisat të gjithë këtyre personave në adresat përkatëse.

37. Çfarë kuptoni me termat: Freeware, Shareware dhe Cardware që shfaqen në Internet?

(3 pikë)

Freeware_____

Shareware

Cardware

Përgjigje:

Freeware – tregon se nuk ka asnjë lloj kufizimi apo autorizimi për instalim programesh.

Shareware – tregon se shkarkimi është falas, por shpërndahe dhe përdoret vetëm për një periudhë kohe.

Cardware – tregon se shkarkimi dhe instalimi janë falas, por autori i fton përdoruesit të dërgojnë nga një kartolinë si shenjë mirënjohje.

38. Cili është ndryshimi midis download dhe upload?

(2 pikë)

Përgjigje :

Download – Ndryshe quhet shkarkim,që do të thotë të transferosh informacione nga një sistem në distancë në një sistem lokal.

Upload – Ndryshe quhet ngarkim dhe është procesi i kundërt në lidhje me download, pra të ngarkosh nga një sistem lokal në një sistem në distancë.

BANKË ME NJËSI TESTESH

DREJTIMI: TIK, Niveli I
LËNDA: “Rrjetet kompjuterike”, klasa 11-të

1. Plotësoni vendet bosh me fjalët e duhura për përcaktimin për rrjetet kompjuterike: **(1 pikë)**

Një rrjet kompjuterik përbëhet prej _____ të lidhur së bashku, të cilët mund të komunikojnë dhe _____ burimet (p.sh. informacionin).

Përgjigje: dy ose më shumë kompjuterash; përbashkësojnë/ndajnë (share)

2. Rrethoni përgjigjen e saktë. Një rrjet kompjuterik brenda një ndërtese quhet ndryshe edhe:

(1 pikë)

- A) MAN (Metropolitan Area Network)
- B) WAN (Wide Area Network)
- C) LAN (Local Area Network)
- D) GAN (Global Area Network)

Përgjigje: C

3. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila nga adresat private IP të listuara më poshtë është e klasit C.

(1 pikë)

- A) 10.20.3.55/8
- B) 172.16.14/16.
- C) 192.168.1.2/24
- D) 255.255.255.0

Përgjigje: C

4. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila nga komandat e mëposhtme teston lidhjen me një klient në distancë (remote client), duke dhënë informacione mbi të gjithë router-at, që gjenden midis router-it të rrjetit lokal dhe routerit të klientit në distancë?

(1 pikë)

- A) ping
- B) tracert
- C) ipconfig
- D) nslookup

Përgjigje: B

5. Nga specifikimi i kabllit 100BaseT CAT5 përcaktoni: llojin e kabllit, kategorinë dhe shpejtësinë e transmetimit. **(3 pikë)**

Përgjigje: Lloji i kabllit është UTP/STP, kategoria 5, dhe shpejtësia e transmetimit 100 Mbps.

6. Përcaktoni tre topologjitë, të cilave u korrespondojnë avantazhet e mëposhtme: **(3 pikë)**

- A) _____ Gjatësi kabli më e shkurtër / kosto të ulta implementimi.
B) _____ N.q.s. bie një nga kompjuterat në rrjet, rrjeti nuk bie.
C) _____ Ka më pak raste përplasje të paketave për shkak të veprimit të të ashtuquajturës Token

Përgjigje: A- Bus; B- Star (Yll); C- Ring (Unazë)

7. Cili nga protokollet e mëposhtme përdoret për marrjen e e-mail-eve nga një *mail client* si Outlook, Outlook Express, Windows Mail, etj.? **(1 pikë)**

- A) TELNET
B) FTP
C) POP
D) DNS

Përgjigje: C

8. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në cilën prej klasave të mëposhtme bëjnë pjesë adresat private 10.17.3.12.2/8. Adresat e kësaj klase përdoren kryesisht për konfigurimin e LAN-eve me një numër të madh hostesh? **(1 pikë)**

- A) Klasa A
B) Klasa B
C) Klasa C
D) Klasa D

Përgjigje: A

9. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila nga vlerat e mëposhtme përcakton saktësisht madhësinë e 1 Gigabyte: **(1 pikë)**

- A) 1024 MB
B) 1000 MB

- C) 10024 MB
- D) 100 MB

Përgjigje: A

10. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në rrjetet TCP/IP, cila nga komandat e mëposhtme paraqet një informacion të shkurtër në lidhje me konfigurimin e kartës së rrjetit (informacioni ka të bejë me adresën e IP-së, subnet mask-ën dhe gateway-in)?

(1 pikë)

- A) ping
- B) tracert
- C) ipconfig
- D) nslookup

Përgjigje: C

11. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në rrjetet TCP/IP, cila nga komandat e mëposhtme “pyet” DNS-në për të marrë informacion në lidhje me emrin e domain-it apo adresën e IP-së?

(1 pikë)

- A) ping
- B) tracert
- C) ipconfig
- D) nslookup

Përgjigje: D

12. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në rrjetet TCP/IP, cila nga komandat e mëposhtme teston lidhjen midis dy kompjuterave në rrjet, duke dërguar një seri paketash nga njëri kompjuter, me qëllim që të marrë një përgjigje nga tjetri?

(1 pikë)

- A) ping
- B) tracert
- C) ipconfig
- D) nslookup

Përgjigje: A

13. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cili nga protokollet e mëposhtme përdoret për dërgimin e e-mail-eve nga një e-mail client si Outlook, Windows Mail, etj.?

(1 pikë)

- A) TELNET
- B) FTP
- C) SMTP
- D) DNS

Përgjigje: C

14. Rrethoni përgjigjet e sakta. Cila nga adresat e mëposhtme ofron numër më të madh hostesh dhe cila numër më të madh rrjetesh? Shkruajeni në kllapa cilin keni zgjedhur për hostet dhe cilin për rrjetet.

(2 pikë)

- A) 10.20.3.55/8
- B) 172.16.14/16.
- C) 192.168.1.2/24
- D) 255.255.255.0

Përgjigje: A-10.20.3.55/8 (rrjetesh); C-192.168.1.2/24 (hostesh)

15. Rrethoni përgjigjen e saktë. Standardi 100Base-T i kablllove, i njohur ndryshe si Fast Ethernet, përdor dy çifte të përdredhura, nga katër që e përbëjnë, për marrje dhe transmetim të dhënash. Cilat janë ato dy çifte?

(1 pikë)

- A) 1, 2 dhe 3, 4
- B. 5, 6 dhe 7, 8
- B) 1, 2 dhe 3, 6
- D. 1, 2 dhe 7, 8

Përgjigje: C

16. Plotësoni fjalitë e mëposhtme:

(3 pikë)

Çdo pajisje në një rrjet identifikohet nga një adresë unike, e quajtur _____.

Çdo kartë rrjeti (NIC) ka një adresë unike _____ bit. Adresat fizike të pajisjeve të rrjetit shkruhen duke përdorur numra _____ (me bazë 16).

Përgjigje: MAC; 48; hexadecimal

17. Adresën IP të mëposhtme shpreheni si adresë binare (1, 0) me 4 oktete:

(4 pikë)

192. 5. 36. 11
Oktet (8 bits) . Oktet (8 bits) . Oktet (8 bits) . Oktet (8 bits)

Përgjigje:

$2^7 2^6 2^5 2^4 2^3 2^2 2^1 2^0$. $2^7 2^6 2^5 2^4 2^3 2^2 2^1 2^0$. $2^7 2^6 2^5 2^4 2^3 2^2 2^1 2^0$. $2^7 2^6 2^5 2^4 2^3 2^2 2^1 2^0$
1 1 0 0 0 0 0 0 . 0 0 0 0 0 1 0 1 . 0 0 1 0 0 1 0 0 . 0 0 0 0 1 0 1 1

18. Plotësoni vendet bosh me fjalët e duhura për formulimin e mëposhtëm.


(2 pikë)

Subnet mask-at matematikisht përcaktojnë _____ që përdoret për të dalluar _____.

Përgjigje: numrin e bit-eve; ID-në e rrjetit

19. Në figurën e mëposhtme përcaktoni llojin e duhur të kabllit për lidhjen e:

(4 pikë)



- A. Switche-ve me njeri tjetrin
- B. Një switch-i dhe një router-i
- C. Një PC me një switch
- D. Një PC me një router

Përgjigje: A- crossover; B- straight-through; C- straight-through;
D- rolled ethernet (RS 232 – RJ45)/console

20. Rrethoni pohimet e sakta:

(2 pikë)

- A) Kabllot prej fibrash optike transmetojnë sinjal në distanca më të largëta se kabllot prej bakri me çifte të përdredhura (twisted pair).
- B) Kabllot prej bakri me çifte të përdredhura kanë më pak interferencë sesa kabllot me fibra optike.
- C) Kabllot prej bakri me çifte të përdredhura me konektorë RJ45 përdoren në topologjinë yll dhe lidhin mes tyre segmente në distancë deri 100 m.
- D) Kategoria 5e e kabllit UTP suporton shpejtësi deri 1GBps në distanca deri 1000 m.

Përgjigje: A; C

21. Shpjegoni shkurt ku përdoret, çfarë shpejtësie suporton, llojin e kabllit që përdor dhe kategoritë e standardit 10GBase-T (802.3.an):

(4 pikë)

Përgjigje:

- Ku përdoret? - për lidhje LAN konvencionale (RJ45 Ethernet)
- Çfarë shpejtësie suporton? - suporton deri 10 Gbps
- Përmes kabllave UTP
- (kategoria 5e, 6, ose 7)

22. Rreshtoni sipas rradhës katër hapat e procesit të kërkimit dhe marrjes së një adrese IP të një klienti nga një DHCP server.

(4 pikë)

Përgjigje: 1. DHCP Discover
2. DHCP Offer
3. DHCP Request
4. DHCP Acknowledgement

23. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në cilën shtresë (Layer), sipas modelit OSI, punojnë switch-et dhe bridge-t?

(1 pikë)

- A) Transport layer
- B) Physical layer
- C) Data link layer
- D) Network layer

Përgjigje: C

24. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cili protokoll përdoret për të gjetur adresën e hardware-it të një pajisjeje lokale?

(1 pikë)

- A) ICMP
- B) ARP
- C) BOOTP
- D) IP

Përgjigje: B

24. Vendosni sipas rradhës shtatë shtresat e modelit OSI.

(7 pikë)

- 1) Transport layer
- 2) Physical layer
- 3) Data Link layer
- 4) Session layer
- 5) Application layer
- 6) Network layer
- 7) Presentation layer

Përgjigje:

- 1) Physical layer
- 2) Data Link layer
- 3) Transport layer
- 4) Network layer
- 5) Session layer
- 6) Presentation layer
- 7) Application layer

25. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në cilën shtresë (layer), sipas modelit OSI, punojnë router-at?

(1 pikë)


- A) Transport layer

- B) Physical layer
- C) Data link layer
- D) Network layer

Përgjigje: D


26. Rrethoni përgjigjen e saktë. Çfarë lloj kablli paraqitet në figurën e mëposhtme?
(1 pikë)

- A) Twisted pair (çifte të përdredhura)
- B) Koaks
- C) Fibër optik
- D) Rollover



Përgjigje: C

28. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në figurën e mëposhtme identifikoni llojet e kabllave që duhen përdorur për lidhjet A (switch – switch) dhe B (PC – switch).
(1 pikë)



- A) A crossover, B crossover
- B) A crossover, B straight-through
- C) A straight-through, B straight-through
- D) A straight-through, B crossover

Përgjigje: B

29. Adresën binare (1, 0) me 4 oktete të mëposhtme shpreheni si adresë IP decimale.
(4 pikë)

1 1 0 0 0 0 0 0 . 0 0 0 0 0 1 0 1 . 0 0 1 0 0 1 0 0 . 0 0 0 0 1 0 1 1

Përgjigje: 192. 5. 36. 11

30. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cili nga protokollet e mëposhtme të shtresës së aplikacioneve krijon një sesion lidhjeje me të sigurtë se TELNET?

(1 pikë)

- A) FTP
- B) SSH
- C) DNS
- D) DHCP

Përgjigje: B

31. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila nga teknologjitë e mëposhtme WAN, të cilat shfrytëzojnë linjat egzistuese të telefonit (POTS), ofron gjerësi bande më të madhe (bandwidth) për shkarkim (download) sesa për ngarkim (upload). Raporti download/upload arrin maksimumi 8Mbps/1,5 Mbps.

(1 pikë)

- A) ADSL
- B) DIAL-UP
- C) DSL
- D) ISDN

Përgjigje: A

32. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cili nga standardet e mëposhtme të rrjeteve pa kabëll (wireless) ofron lidhje në të dyja frekuencat 2,4 GHz/5GHz?

(1 pikë)

- A) 802.11n
- B) 802.11b
- C) 802.11g
- D) 802.11

Përgjigje: A

33. Rrethoni përgjigjen e pasaktë në lidhje me Address Resolution Protocol.

(1 pikë)

- A) Punon në shtresën e dytë – Data Link Layer të modelit OSI (Layer 2)
- B) Shërben për gjetjen e adresës MAC të një hosti me adresë IP të njohur
- C) Komanda arp bazohet në një tabelë “përkthimi adresash”
- D) Shërben për gjetjen e adresës IP nga adresa MAC

Përgjigje: D

34. Rrethoni përgjigjet e sakta. Cila nga zgjedhjet e mëposhtme mund të konsiderohen si praktika të mira sigurie për rrjetet wireless?

(3 pikë)

- A) Çaktivizimi i WPA2
- B) Aktivizimi i WPA2
- C) Çaktivizimi i MAC filtering
- D) Aktivizimi i MAC filtering
- E) Aktivizimi i SSID broadcasting
- F) Çaktivizimi i SSID broadcasting

Përgjigje: B; D; F

35. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cili nga numrat binarë të mëposhtëm është numri decimal 137?

(1 pikë)

- A) 10001001
- B) 10101001
- C) 11001001
- D) 10000101

Përgjigje: A

36. Plotësoni fjalitë e mëposhtme me shtresat (layers) korresponduese sipas modelit OSI:

(4 pikë)

A) Në modelin OSI, _____ është përgjegjës për routim-in dhe adresimin logjik.

B) Për copëzimin e të dhënave në segmente më të vogla është përgjegjës _____.

C) _____ është përgjegjës për marrjen dhe transmetimin e sinjaleve të strukturuar elektrike si rrjedhë bit-esh.

D) _____ formaton të dhënat që duhet t'i paraqiten shtresës së aplikacioneve.

Përgjigje: **A-** network layer; **B-** transport layer; **C-** Physical layer; **D-** Presentation layer

37. Rrethoni përgjigjet e sakta. Më poshtë janë dhënë disa nga karakteristikat e protokolleve TCP dhe UDP. Tregoni cilat karakteristika i përkasin protokollit UDP.

(2 pikë)

A) Shpejtësi më e lartë

B) Besueshmëri

C) Orientim nga lidhja (connection oriented)

D) Nuk ka kontrolle të tepruara gjatë transportit

E) Ngarkesë më e madhe gjatë transportit

Përgjigje: A; D

38. Tregoni se cilat janë tri kërkesat bazë (objektivat bazë) të sigurisë së të dhënave.

(3 pikë)

A) _____ nënkupton që informacionet/të dhënat, t'u arrijnë atyre të cilëve u lejohet t'i zotërojnë.

B) _____ nënkupton garancinë që të dhënat që sistemi ofron të jenë të sakta duke mundësuar transmetimin e saktë të tyre (ose orrigjimin në rast se identifikohen gabime), si dhe mbrojtjen nga manipulimet.

C) _____ nënkupton garancinë që duhet të japë sistemi që të dhënat që ai përpunon të jenë të aksesueshme kur të kërkohen.

Përgjigje: **A-** Besueshmëria (**C**onfidentiality); **B-** Integriteti (**I**ntegrity); **C-** Disponueshmëria (**A**vailability)

39. Më poshtë janë dhënë disa nga protokollet më të njohura. Çiftojini ato me portat përkatëse.

(6 pikë)

HTTP 25


POP3 110

SMTP 53

FTP 22

SSH	21
DNS	80
	443

Përgjigje:



40. Rrethoni përgjigjen e pasaktë në lidhje me protokollin IPv6.

(1 pikë)

- A) Nëpërmjet këtij protokoll synohet të shmanget mungesa e adresave IP
- B) Adresa e Ipv6 përbëhet nga 128 Bit
- C) Adresa e Ipv6 përbëhet nga 32 Bit
- D) Ka si avantazh rritjen e sigurisë dhe ofrimin e QoS (Quality of Service)

Përgjigje: C

41. Rrethoni përgjigjen e saktë. Sa bit-e nga subnet maska nevojiten për të krijuar të paktën 20 subnet-e?

(1 pikë)

- A) 3
- B) 4
- C) 5
- D) 6

Përgjigje: C

42. Rrethoni përgjigjen e saktë. Pasi të kryeni llogaritjet, tregoni se cila do të ishte subnet maska e duhur.

(6 pikë)

Përgjigje:

Për të marrë 12 subnete nevojiten 4 bite nga bitet e ID së rrjetit - 4 bits ($2^4 = 16$ rrjete). Meqë kemi të bëjmë me rrjet të klasës B me default subnet mask 255.255.0.0, 4 subnet bit-et do të merren nga oktet i tretë:

11111111.11111111.11110000.00000000

Konvertuar në decimal:

255. 255. 240. 0

43. Rrethoni përgjigjen e saktë. Njëri nga kompjuterat nuk bën ping adresat e tjera të rrjetit lokal LAN. Kablli dhe karta e rrjetit janë testuar dhe punojnë në rregull. Pas verifikimit të konfigurimit me ipconfig /all shihet se adresa e kompjuterit është 169.254.2.1 (APIPA). Çfarë tregon kjo e dhënë?

(1 pikë)

- A) Routeri nuk funksionon siç duhet
- B) Kompjuteri ka konfigurim manual të gabuar të adresës së IP-së së kartës
- C) Kompjuteri nuk ka marrë adresë IP nga serveri DHCP
- D) Asnjë nga përgjigjet e mësipërme

Përgjigje: C

44. LED-i i kartës së rrjetit nuk ndriçon (nuk tregon lidhje). Jepni katër arsye që mund të kenë shkaktuar këtë defekt.

(4 pikë)

- A) _____
- B) _____
- C) _____
- D) _____

Përgjigje: A. Karta e rrjetit me defekt
B. Patchkabli me defekt
C. Porta e switch-it (ose i gjithë switch-i) me defekt
D. Priza e rrjetit me defekt

45. Gjeni për cilat sisteme mbrojtjeje bëhet fjale në përkufizimet e mëposhtme:

(4 pikë)

_____ është një system sigurie rrjeti, software ose hardware, i cili kontrollon trafikun në hyrje dhe dalje të rrjetit bazuar mbi një bashkësi të rregullash të aplikuara. Ai vendos një barrierë midis një rrjeti të besuar të brendshëm (LAN) dhe një rrjeti tjetër, i presupozuar jo i besuar si p.sh. Interneti.

(2 pikë)

_____ është një pajisje apo aplikacion që monitoron rrjetin kompjuterik ose sistemin për aktivitete të dyshimta, keqdashëse, shkelje të politikave të kompanisë duke gjeneruar një raport për administratorët e sistemit. Ai mund të krahasohet me një system alarmi të instaluar në shtëpi/dyqan, i cili bie kur hyjnë hajdutët.

(2 pikë)

Përgjigje:

Firewall-i – është një system sigurie rrjeti, software ose hardware, i cili kontrollon trafikun në hyrje dhe dalje të rrjetit bazuar mbi një bashkësi të rregullash të aplikuara. Ai vendos një barrierë midis një rrjeti të besuar të brendshëm (LAN) dhe një rrjeti tjetër, i presupozuar jo i besuar si p.sh. Interneti.

IDS – Intrusion Detection System (IDS) - është një pajisje apo aplikacion që monitoron rrjetin kompjuterik ose sistemin për aktivitete të dyshimta, keqdashëse, shkelje të politikave të kompanisë duke gjeneruar një raport për administratorët e sistemit. Ai mund të krahasohet me një system alarmi të instaluar në shtëpi/dyqan, i cili bie kur hyjnë hajdutët.

46. Çfarë kuptohet me kabllim të strukturuar dhe çfarë paraqet secila nga tre zonat?

(6 pikë)

Kabllimi i strukturuar paraqet një plan instalimi për një kabllim të njëjtë për shërbime të dryshme (të dhëna (data), video, telefoni), si dhe hedh bazat për një infrastrukturë rrjeti të orientuar nga e ardhmja, pra që t'i paraprijë ndryshimeve që mund të kryhen në të ardhmen. Parë nga një perspektivë tri dimensionale, dallojmë 3 zona. Cilat janë këto zona dhe çfarë paraqet secila prej tyre?

(2 pikë secila)

Përgjigje:

Zona e parë përshkruan kabllimin midis ndërtesave të vendosura brenda një hapësire të caktuar (site). Këtu bëhet fjalë për distanca deri në 1500 m. Si kabëll përdoren fibrat optike.

(2 pikë)

Zona e dytë përshkruan lidhjen midis kateve të ndërtesës, si dhe përfshin kabllin lidhës dhe shpërndarësin respektiv të katit (switch-in). Si kabëll përdoren fibrat optike sipas standardit deri në një gjatësi maksimale prej 500 m.

(2 pikë)

Zona e tretë përfshin elementët e kabllimit horizontal të katit (kablli nga shpërndarësi (switch-i) i katit deri tek priza fundore e rrjetit). Si kabëll përdoret Twisted-Pair (deri në 100 m), ose më rrallë fibrat optike.

(2 pikë)

47. Një kampus universitar përbëhet nga dy ndërtesa. Ndërtesa e parë ka sallat e mësimdhënies dhe zyrat e administratës, ndërsa e dyta sallat e studimit dhe fjetoret e studentëve. Distanca midis dy ndërtesave është 1200 m. LAN-et e ndërtesave duhet të lidhen me njera tjetrën. Në katin përdhes të ndërtesës së parë është vendosur një rack, në të cilin janë instaluar patchpanel-et dhe switch-i, që mbulojnë lidhjet e portave të rrjetit të katit përdhes dhe katit të parë. Për të lidhur portat e rrjetit në katin e dytë, gjatësia e kabllit të përdorur, UTP CAT6, i kalon 100 m. Në katin përdhes, pranë murit ku kalojnë kabllot që lidhin portat e rrjetit të një klase, është instaluar një gjenerator, i cili futet në punë kur ka ndërprerje të rrymës elektrike.

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme duke propozuar zgjidhjen përkatëse:

(6 pikë)

A) Çfarë kablli duhet përdorur për të lidhur rrjetet e dy ndërtesave. Arsyeoni përse.

(1 pikë)

B) Çfarë zgjidhje propozoni për lidhjen në rrjet të katit të dytë. Arsyeoni përse.

(3 pikë)

C) Duke qenë pranë murit ku kalojnë kabllot, gjeneratori mund të krijojë interferencë sinjali.

Çfarë kablli duhet përdorur në këtë rast nga patchpaneli deri tek portat e rrjetit të klasës?

(2 pikë)

Përgjigje:

- A.** Duhet përdorur kabëll fibër optike, pasi ai suporton distanca deri 1500 m pa humbje sinjali.
- B.** Në katin e dytë mund të vendoset një rack, patchpanel dhe një switch, i cili do të lidhet me katin përdhes. Në këtë rast lidhjet do të fillojnë nga patchpaneli i katit dhe nuk i kalojnë 100 m që është distanca e transmetimit pa humbje të kabllit UTP.
- C.** Në këtë rast duhet përdorur kabëll UTP i skremuar (shielded) / STP, i cili mbron sinjalin nga interferencat.

BANKË ME NJËSI TESTESH

DREJTIMI:

TIK, Niveli I

LËNDA:

“Sistemet e shfrytëzimit”, klasa 10-të dhe 11-të

1. Rrethoni përgjigjen e saktë. Software-i pa të cilin nuk mund të startojë kompjuteri është:

(1 pikë)

- A) paketa Office
- B) programi aplikativ
- C) sistemi operativ
- D) control panel-i

Përgjigje: C

2. Rrethoni përgjigjen e saktë. Viruset Spyware dhe Adware janë:

(1 pikë)

- A) mikroorganizma
- B) programe
- C) sisteme operative
- D) peer to peer

Përgjigje: B

3. Rrethoni përgjigjen e saktë. Komanda cd në Linux tregon:

(1 pikë)

- A) ekzekutimin e procesit në background
- B) ndan komandat e të njëjtit rresht
- C) ndryshon direktorin
- D) lidh karaktere në filename

Përgjigje: C

4. Rrethoni përgjigjen e saktë. Komanda chmod shërben për:

(1 pikë)

- A) ndryshimin e grupit të një file
- B) tregon në video
- C) krijon arkivë
- D) ndryshon lejet e një file

Përgjigje: D

5. Rrethoni përgjigjen e saktë. Komanda Cp në Linux tregon:

(1 pikë)

- A) riemëron një skedar
- B) fshin një skedar
- C) kopjon një ose më shumë skedarë
- D) instalon një file

Përgjigje: C

6. Cilat janë funksionet e sistemit operativ :

(4 pikë)

Përgjigje:

Sistemi operativ menaxhon të gjitha programet e tjera në kompjuter, ruan file-t, i mundëson shfrytëzuesit të përdorin programet software-ike dhe koordinon shfrytëzimin e hardware-it kompjuterik

7. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila nga karakteristikat e Windows 7 na lejon të bëjmë rikthim të instalimit (recover) jo korrekt të një driver për një pajisje:

(1 pikë)

- A) Driver Signing
- B) Driver Rollback
- C) Plug and Play
- D) Windows Hardware Quality Laboratory (WHQL)

Përgjigje: B

8. Cilat nga shprehjet e dhëna nuk janë të sakta? (Rretho më shumë se 1 përgjigje):

(2 pikë)

- A) 1 bit > 8 byte
- B) 16 bit < 2 byte
- C) 32 bit < 4 byte
- D) 32 bit < 6 byte

Përgjigje: A,B,C

9. Rrethoni përgjigjen e saktë. Komanda echo në Linux:

(1 pikë)

- A) fshin ekranin
- B) afishon në ekran
- C) shfaq orën dhe datën e sistemit
- D) afishon të drejtat e aksesit

Përgjigje: B

10. Rrethoni përgjigjen e saktë. Çfarë është hardware:

(1 pikë)

- A) pjesë programore e sistemit kompjuterik
- B) pjesët fizike e sistemit kompjuterik
- C) ndërlidhës ndërmjet programeve dhe sistemit operativ
- D) është server i kompjuterit

Përgjigje: B

11. Cili është koncepti bazë i linux dhe ndryshimi me MS-DOS?

(2 pikë)

Përgjigje:

Linux është një sistem operativ multitasking, multiuser që do të thotë se, shumë njerëz, mund të veprojnë me shumë aplikacione në një kompjuter të vetëm, në të njëjtën kohë. Kjo është diferenca nga MS-DOS, ku një person i vetëm mund ta përdorë sistemin në një kohë.

12. Kush pershkruan me mire funksionin e Windows Firewall:

(1 pikë)

- A) Windows Firewall ndalon aksesimin e skedareve te sistemit nga perdoruesit e paautorizuar
- B) Windows Firewall mbron kompjuterin nga temperaturat e larta
- C) Windows Firewall mbron kompjuterin nga sulmet nga perdorues ose programe malicious ne internet
- D) Windows Firewall shifron skedaret e te dhenave ne nje kompjuter

Përgjigje : C

13. Përse shërbejnë programet e kompjuterit?

(2 pikë)

Përgjigje :

Programet janë një bashkësi udhëzimesh, që instalohen në kujtesën e përhershme të kompjuterit dhe zbatohen në një proces konkret.

14. Çfarë quajmë File system?

(1 pikë)

Përgjigje:

File System janë ato programe që shërbejnë për të koordinuar veprimtarinë e kompjuterit dhe jo për të plotësuar morinë e kërkesave që i paraqiten përdoruesit në jetën e përditshme.

15. Çfarë quajmë Programe Aplikative?

(2 pikë)

Përgjigje:

Programe Aplikativë, janë ato programe që shërbejnë për të kryer detyra konkrete në fusha të ndryshme dhe që janë të domosdoshme ose janë programet bazë të kompjuterit.

16. Përmendni të paktën katër programe sistemi ose sisteme operative.

(4 pikë)

Përgjigje:

MS-DOS, UNIX, LINUX, Microsoft Windows Xp, MacOS, Windows 7, Windows Vista, Windows 8

17. Çfarë përfaqëson një ikonë?)

(1 pikë)

Përgjigje :

Ikona është një logo, simbol ose një stemë e cila përfaqëson një program të caktuar

18. Çfarë quajmë driver dhe për çfarë shërben ai?

(2 pikë)

Përgjigje :

Driver është një grup komandash ose një grup instruksionesh, të cilat shërbejnë për të kryer një funksion të caktuar, për të vënë pajisjen në punë.

19. Cili nga skenarët e mëposhtëm përshkruan më mirë një rrjet të tipit workgroup:

(2 pikë)

- A) Një grup i vogël kompjuterash që ndajnë skedarë me njëri-tjetrin, ku çdo kompjuter ka një liste përdoruesish të autorizuar
- B) Një rrjet i madh me qindra kompjutera dhe bazë të dhënash qendrore për përdoruesit
- C) Një kompjuter të lidhur në Internet me modem
- D) Asnjë

Përgjigje: A

20. Komponentet e sistemit kompjuterik janë:

(4 pikë)

Përgjigje:

Hardware, sistemi operativ, sistemet aplikative, shfrytëzuesi

21. Shpjegoni termat:

(3 pikë)

Folder _____

File _____

Ntfs _____

Përgjigje:

- Folder quhet dosja ose zarfi që përmban dokumente të ndryshme në brendësi
- File quhet skedari ose dokumenti në një sistem kompjuterik
- Ntfs (new technology file system) është skedar i sistemit që përdoret zakonisht në formatimin e kompjuterit me windows XP.

22. Çfarë tregon simboli # dhe çfarë tregon simboli \$ në sistemet Linux?

(2 pikë)

Përgjigje:

- Simboli # tregon kur përdoruesi është loguar si root ose si administrator
- simboli \$ tregon që përdoruesi nuk është root, pra është si një user i thjeshtë i loguar në system

23. Cfarë tregon komanda date në linux?

(1 pikë)

Përgjigje:

Kjo komandë tregon datën dhe orën aktuale në sistem

24. Tregoni disa direktori bazë të një sistemi skedarësh në Linux (përmendni të paktën 3 direktori):

(3 pikë)

Përgjigje:

Direktoritë bazë janë: /bin, /sbin, /var, /dev, /usr, /etc, /tmp, /home, /root

25. Plotësoni përkufizimin e komandës “who am I” në linux:

(3 pikë)

Komanda “who am I” _____ informacionet që afishohen nga komanda _____, por vetëm rreth përdoruesit që po përdor _____

Përgjigje:

Komanda “who am I” **afishon** informacionet që afishohen nga komanda **who**, por vetëm rreth përdoruesit që po përdor **terminalin lokal**.

26. Çfarë tregon komanda usermod në linux?

(1 pikë)

Përgjigje :

Komanda usermod lejon që një përdorues root të modifikojë një llogari përdoruesi

27. Shpjegoni shkurt mënyrën e funksionimit të sistemeve Multi-Tasking?

(2 pikë)

Përgjigje:

Sistemet Multi-Tasking lejojnë kryerjen e njëhershme të shumë programeve njihen edhe ndryshe si shumë-detyrësh (Windows-NT , Linux)ku një program mund të ndërpritet dhe CPU-ja (Proçesori) i kalohet një programi tjetër.

28. Për çfarë dhe si përdoret komanda “passwd” në linux? Ilustroni përdorimin e kësaj komande me anë të një shembulli.

(6 pikë)

Përgjigje:

Kjo komandë përdoret nga një përdorues për të ndryshuar fjalëkalimin aktual. Fillimisht kërkohet fjalëkalimi aktual, pastaj fjalëkalimi i ri dhe në fund kërkohet të rishkruhet fjalëkalimi i ri. Fjalëkalimet ruhen të koduara në skedarin e sistemit **/etc/passwd**.

Shembull:

```
[root@localhost~]#passwd
```

```
Old password:*****
```

```
New password:*****
```

```
Re-enter new password:*****
```

29. Cili është ndryshimi i komandës “whoami” (fjalët bashkë) me komandën “who am i” (fjalë me hapësirë midis tyre) në sistemin Linux?

(2 pikë)

Përgjigje:

Komanda “whoami” afishon vetëm emrin e përdoruesit që është duke përdorur terminalin lokal ndërsa komanda “who am i” me hapësirë, afishon informacionet që afishohen nga komanda who, por vetëm rreth përdoruesit që po përdor terminalin lokal.

30. Shkruani tre karakteristikat e sistemit operativ UNIX:

(3 pikë)

Përgjigje:

UNIX është një nga sistemet operative në dispozicion për përdorim në kompjuterat personal, serverat dhe rrjetet. Është sistem më efikas dhe më i besueshëm se sa sistemet e tjera. Sistemi UNIX është i aftë të kryejë detyra të shumta nga përdorues të shumtë brenda kuadrit, në të njëjtën kohë.

31. Cili janë ndryshimet midis arkitekturës 32 bit dhe 64 bit në një sistem kompjuterik?

(2 pikë)

Përgjigje :

Ajo që është e ndryshme ndërmjet arkitekturës 32 bit dhe 64 bit është numri i linjave të komunikimit, 32 bit përbëhet nga 32 linja komunikimi dhe përdoret për procesorët single core ose të vetëm, ndërsa arkitektura 64 bit ka 64 linja komunikimi dhe përdoret zakonisht tek më shumë se 2 procesorë.

32. A mund të instalohet një sistem operimi 64 bitësh (x64) në një kompjuter me arkitekturë 32 bit single-core procesor? Argumentoni përgjigjen tuaj.

(2 pikë)

Përgjigje:

Jo, sepse sistemet e operimit 64 bitësh përdoren në linja të komunikimit me arkitekturë 64 bit, dhe në bazë të programaturës që është hartuar nuk ka përputhje me sistemin 32 bitësh.

33. Jepni karakteristikat e adresave absolute në Linux:

(5 pikë)

Përgjigje:

Japin adresën e plotë të vendndodhjes së skedarit ose direktorisë. Fillon gjithnjë nga maja e hierarkisë së sistemit të skedarëve, pra nga root(/). Fillon gjithnjë me (/). Nuk varet nga direktoria ku ndodhemi aktualisht në hierarki. Është gjithnjë unike në të gjithë hierarkinë.

34. Jepni karakteristikat e adresave relative në Linux:

(4 pikë)

Përgjigje:

Fillojnë gjithnjë nga direktoria ku ndodhemi aktualisht në hierarki. Nuk fillojnë kurrë me (/). Janë adresa relative vetëm për vendndodhjen aktuale. Zakonisht janë më të shkurtra se adresat absolute respektive.

35. Për çfarë përdoret komanda ls -l?

(1 pikë)

Përgjigje:

Komanda ls -l përdoret për të afishuar karakteristikat (atributet) e një skedari.

36. Shpjegoni çdo komandë të dhënë në shembullin e mëposhtëm duke ndjekur rrjedhën logjike në sistemin Linux:

(6 pikë)

\$pwd

/home/dshk

\$mkdir viti

\$mkdir viti/sem1

\$cd viti

\$touch sem3.txt

\$ls

Sem1 sem3.txt

Përgjigje:

\$pwd //afishojmë direktorinë aktuale të punës

/home/dshk

\$mkdir viti //krijomë direktorinë viti

\$mkdir viti/sem1 //krijomë direktorinë sem1 nën viti

\$cd viti //pozicionohemi në direktorinë e punës viti

\$touch sem3.txt //krijomë në viti një skedar bosh me emrin sem3 të tipit text

\$ls //afishojmë përmbajtjen e direktorisë të punës viti

Sem1 sem3.txt

37. Cili është dallimi midis opsionit switch user dhe log off në butonin start të kompjuterit?
(2 pikë)

Përgjigje :

- Switch User - Opsioni i ndërrimit të përdoruesit do të mundësojë kalimin në një përdorues tjetër, por pa mbyllur programet tek secili përdorues.
- Log off- Kur zbatohet procedura log off, të gjitha programet në përdorim mbyllen por kompjuteri nuk fiket. Ai vihet në dispozicion të një përdoruesi tjetër i cili mund të logojë pa u shqetësuar për humbje të mundshme informacioni.